



GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES SË NXËNËSVE
NË FUND TË CIKLIT TË TRETË TË SHKOLLËS FILLORE

MAJ, VITIT MËSIMOR 2019/2020

UDHËZIM

Koha për zgjidhjen e testit është **70 minuta**.

Mos e hap testin dhe mos fillo t'i zgjidhës detyrat para se të japë leje mësimdhënësi kujdestar.

Testi **DUHET** të jetë i shkruar me laps kimik ose me stilolaps.

Shkruaj lexueshëm dhe me shkronja dore.

Nëse shkruan me shkronja shtypi, thekso shkronjën e madhe atje ku duhet të jetë. Respekto rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore. Nëse mendon se ke gabuar në zgjidhjen e detyrës, vendos një vijë të kryqëzuar (X) mbi të dhe zgjidhe përsëri.

Nuk guxon ta përdorësh korrektorin.

Detyrat nuk e ke për detyrë t'i zgjidhësh me rend ashtu siç janë dhënë në test.

Nëse e përfundon punën më parë, kontrolloji edhe një herë zgjidhjet tua.

Detyra do të vlerësohet me zero pikë nëse:

→ është e pasaktë

→ është e palexueshme dhe nuk është e qartë

→ është e shkruar me laps grafit/të thjeshtë

→ është shkruar ose rrethuar edhe përgjigjja e saktë dhe e pasaktë

ME FAT!

SHIFRA E NXËNËSIT

FAQJA E ZBRAZËT

Lexo tekstin pastaj përgjigju në pyetjet 1, 2, 3, 4 dhe 5.

SHIJET pa aroma dhe ngjyra artificiale **SHIJET**

përzierja për përgatitje SPAGETA BOLONJEZE

Për përgatitjen e 4 racioneve nevojiten 300 g mish të grirë, 1 qepë e vogël, 1 karotë, 350 g spageta, 2 lugë vaj ullirit ose 50 g gjalpë.

UDHËZIM PËR PËRGATITJE:

1. Spagetat të zihen 8 deri në 10 minuta dhe të kullohen
2. Në vaj ose gjalpë skuqeni qepën e prerë imët dhe karotën e grirë imët pastaj shtojeni mishin.
3. Përmbajtjen e qeses hidhni në një gjysmë litre ujë të vakët dhe hidhni në mishin e skuqur, kthejeni mbi zjarr dhe lëreni të vlojë.
4. Të zihet në zjarrin e lehtë rreth 10 minutash me përzierje të herë pas hershme. Të servohet me spagetat e ziera.

10 min

PËRBËRËSIT: domate të thara 35%, miell gruri, sheqer, kripë kuzhine, rrënjë selino e tharë, rrënjë majdanozi i tharë, hudhër. Mund të përmbaj qumësht dhe vezë në gjurmë.

VLERAT USHQYESE MESATARE:
Kalori 1313 kJ
Yndyrë 3,5 g (nga të cilat acidi yndyror i ngopur 2 g)
Karbohidratet 53 g (nga të cilat sheqernat 37 g)
Fibra 9,8 g
Proteina 12 g
Kripë 12,1 g

recetat e reja në www.shijet.com

1. Shijet janë:

1. përshkrimi i procesit të punës
2. përzierja për përgatitjen e ushqimit
3. udhëzimi për spagetat bolonjeze

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë

2. Nëse konstatimi është i saktë, rretho S, ndërsa nëse është i pasaktë rretho P, pastaj argumentoje përgjigjen.

Për përgatitjen e spagetave bolonjeze nevojiten 10 minuta. S P

Argumentimi:

1 pikë	
--------	--

3. Përshkruaje të dhënën e cila tregon në çfarë mënyre mund të gjenden më shumë receta.

1 pikë	
--------	--

4. Me cilin qëllim, në mes të përbërësve, është shkruar fjalia:

Mund të përmbaj qumësht dhe vezë në gjurmë?

1. Të tregojë për vlerat ushqyese të ushqimit.
2. Të paralajmërojë personat alergjik në përbërjen e prodhimit.
3. Të kumtojë që këta përbërës rrisin shijen e spagetave bolonjeze.

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë	
--------	--

5. Shkruaj me sa gram në mes të vlerave mesatare ushqyese janë të përfaqësuar karbohidratet.

1 pikë	
--------	--

Lexo këngën II nga *Këngët e Milosaut* të Jeronim De Radës pastaj përgjigju në pyetjet 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11.

KËNGA II

Vreshtat ishin verdhëloze.
Erdh nga mali dhelpëra
Me të lodhurat të bijat,
me të mbaruar të vjelat;
e at`here kur ndër sheshe
fshihet dielli (si nën tokë
mëmat që kënduan në valle),
kur në Fjokat unë rashë.
E përveshur e e lartë,
me gërshet të pleksur
në një lidhëse të bardhë,
ish te kroi një vash`.Te balli
një mendim i kishte hie.
I lidhur te brezi i kaltër,
mbi truall i çik mandili.
Posa që më ndjejt,
vasha drejt nga unë u suall,
gjifyrë edhe plot hie,
me një të trembur hare.

Trimi : - Vajzë, a m`ep ti një pike ujë?
Vajza: - Sa te duash t`i , bir zoti.
- kuja bije je ti, vashë?
Mos më je nga dheu i huaj?
Kur, djalosh, në Selanik
vajta, vashëzat nuk ishin
në katund me kaq hir.
Në çeret e ndezur,
vucen ajo ngrinte:
-Jam e bijë e Kollogresë,
ngriti ballët e zbuluar.
Duke shkuar asaj udhe,
gjembat që vareshin udhës
s`e gërvishtnin atë çupë:
me llërët përgjakur,
unë nga ballët ia reshtja.
Dy buzë të qeshura,
njëj here të bardhë,
at mbrëmje dukeshim.

6. Cila është tema e kësaj kënge ashtu si edhe e veprës në tërësi?

1 pikë

7. Me çfarë nis kënga?

1 pikë

8. Poeti Rinën e portretizon fizikisht dhe në aspektin moral e shpirtëror.

Veço ndonjë përshkrim të këtyre dy portreteve të vajzës.

• Portreti fizik:

• Portreti moral – shpirtëror

1 pikë

9. Rretho numrin para llojit të vargut me të cilin është shkruar kënga.

1. tetërrokësh
2. nëntërrokësh
3. dhjetërrokësh

1 pikë

10. Në këtë poezi zhvillohet edhe dialogu me qëllim të prezantimit të personazheve. Ilustroje me shembuj një prej tyre.

1 pikë

11. Lexo edhe një herë vargun e gjashtë dhe të shtatë të këngës.

A) Cilën figurë stilistike kemi në këto dy vargje?

1 pikë

B) Argumentoje përgjigjen nën A, duke treguar çfarë dëshiron të thotë poeti me këtë figurë.

1 pikë

12. Fjalëve të mëposhtme shkruaju sinonimet:

mbaruar _____

përveshur _____

1 pikë

13. Në njëqindvjetorin e vdekjes së Njegoshit.

Shkruaj cilës pjesë të ligjeratës i përket fjala e nënvizuar.

1 pikë

- 14.** Lidhe titullin e veprës dhe llojin letrar me emrin e personazhit në tabelë (ashtu siç është filluar). Bëj kujdes, një vepër letrare dhe një lloj letrar janë të tepërt.

<i>Romeo dhe Zhuljeta</i>	komedi
<i>Këngët e Milosaut</i>	roman
<i>Tregtar flamujsh</i>	poemë epiko-lirike
<i>Katërmbëdhjetë vjeç dhëndër</i>	tragjedi

PERSONAZHI LETRAR	VEPRA	LLOJI LETRAR
Zhuljeta	<i>Romeo dhe Zhuljeta</i>	<i>tragjedi</i>
Hilush Vilëza		
Zonja mëmë		

2 pikë

- 15.** Në fjalinë e mëposhtme gjeje mënyrën dhe kohën e foljes së nënvizuar.

Duke dashur të shpëtoja nderin, flisja nëpër dhëmbë.

Mënyra e foljes _____

Koha e foljes _____

2 pikë

- 16.** Fjalët nga kllapat përdori në formën e duhur, dhe trego rasën e tyre.

1. Shikonim si _____ e gërryenin tokën.
(ekskavatori i madh i verdhë)

rasa _____;

2 pikë

2. Pjesën dërmuese të pushimit e kemi kaluar në _____.
(Podgorica)

rasa _____.

2 pikë

- 17.** A) Lexo fjalinë. Në të është bërë një gabim. Vëreje atë dhe përmirësoje gabimin duke e përshkruar saktë fjalinë.

„Kur shikojmë këto kostume na duket sikur parakalojmë krahinat e ndryshme të Shqipërisë Malësia e Madhe, Zadrima, Kukësi, Dardha, Myzeqeja, Tirana, Dropulli.”

	1 pikë	
--	--------	--

- B) Argumentoje përgjigjen.

	1 pikë	
--	--------	--

- 18.** A) Lexo fjalinë pastaj shkruaje atë në njëjës.

Shikuesit kanë qenë të ngazëllyer me shfaqjen.

	1 pikë	
--	--------	--

- B) Lexo fjalinë dhe pjesën e nënvizuar shkruaje në vetën e parë shumës.

Unë gjithmonë do t'i gëzohesha ardhjes së tezes.

	1 pikë	
--	--------	--

- 19.** Lexo fjalinë pastaj zhvillo detyrën.

„Gëzuar ditëlindjen“, bërtita me mallëngjim duke hequr kapelën.

Nëse konstatimi është i saktë, rretho S, kurse nëse nuk është i saktë, rretho P dhe argumento përgjigjen.

KONSTATIMI	SAKTË PASAKTË	ARGUMENTIMI I PËRGJIGJES
Fjalët e nënvizuara kanë funksionin e kallëzuesit.	S P	

	1 pikë	
--	--------	--

A series of horizontal lines for writing, consisting of a dashed top line followed by 28 solid lines.

E PLOTËSON KOMISIONI PËR VLERËSIM

Numri i përgjithshëm i pikëve të fituara në test: _____

Nota: _____

KOMISIONI:

VLERËSUESI KRYESOR: _____

Data _____ 2020